

VENDIM
Nr.792, datë 26.11.2003

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË ISH-FONDACIONEVE PËR NDËRTIMIN E
APARTAMENTEVE PËR KREDITORËT QË KANË HUMBUR BANESAT NGA RËNIA E
SKEMAVE PIRAMIDALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7/8 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet financiare prej 240 000 000 (dyqind e dyzet milionë) lekësh, gjendje në llogaritë e ish-fondacioneve bamirëse në administrim, në Bankën Kombëtare Tregtare dhe Bankën e Kursimeve, Tiranë, të transferohen në një llogari të veçantë "Fonde për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale" për Entin Kombëtar të Banesave.

2. Fondet financiare, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, për Entin Kombëtar të Banesave, për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët të cilët humbën banesat nga rënia e skemave piramidale, të përdoren si më poshtë vijon:

- 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekë nga Bashkia e Tiranës;
- 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekë nga Bashkia e Vlorës.

3. Në Bashkinë e Tiranës, ndërtimi i apartamenteve të banimit për kreditorët, me fondet e mësipërme, të fillojë me 3 godinat në ndërtim në zonën e Laprakës, Tiranë, sipas projektit të miratuar për ndërtim banesash publike, ndërsa në Bashkinë e Vlorës të fillojë me përgatitjen dhe fillimin e punimeve të ndërtimit për ngritjen e godinave në objektin ish-frigoriferi, Vlorë.

4. Sipërfaqet e trojeve për ndërtimin e apartamenteve të banimit për kreditorët që humbën banesat nga rënia e skemave piramidale, me fondin e kredisë greke për strehim dhe me fondet e planifikuara nga Buxheti i Shtetit në Laprakë, Tiranë dhe në ish-frigoriferin, Vlorë, të vihen në administrim të Entit Kombëtar të Banesave për vazhdimin e ndërtimit të apartamenteve për këta kreditorë.

5. Familjet e pastreha, që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale, përfitojnë apartamente banimi, të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, në përputhje me vendimet e këshillave bashkiakë të Tiranës dhe të Vlorës, sipas listave parësore dhe emergjente që këto këshilla paraqesin në Entin Kombëtar të Banesave, në zbatim të rregullave dhe kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.321, datë 5.7.1999 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar.

6. Të ardhurat e siguruara nga këstet e derdhura të familjeve të pastreha, të përcaktuara në kontratën e shitblerjes së apartamenteve, të lidhur ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe kryefamiljarit, të riderdhen në llogarinë "Fonde për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale" dhe të përdoren për vazhdimin e ndërtimit të apartamenteve për këta kreditorë.

7. Enti Kombëtar i Banesave të kryejë procedurat e prokurimit publik, brenda tremujorit të parë të vitit 2004.

8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe Enti Kombëtar i Banesave për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano